



CILI ËSHTË KONTRIBUTI I SHBA-së NË GJYKATËN SPECIALE?

FACE 4



Presidenti amerikan Donald Trump përmes një urdhri ekzekutiv ka ngrirë për 90 ditë ndihmën ndërkombëtare. Ky urdhër ka prekur edhe Gjykatën Speciale, në të cilën

janë duke u gjykuar liderët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi. Zëdhënësja e Speciales nuk ka dhënë informacione nëse stafi i

gjykatës që vjen nga ShBA-ja preket nga ky vendim ose jo. Ajo ka thënë se ShBA-ja kryesisht kontribuon në financimin e disa punonjësve, por pa dhënë hollësi

NJERIU I RI I DIALOGUT: ÇFARË MUND TË PRESIM NGA PETER SORENSEN?

F. 7



QEVERIA IA JEP 100 HEKTARË PËR SHFRYTËZIM MINISTRISË SË MBROJTJES

F. 7



PAK DITË PARA ZGJEDHJEVE, POSTA SHPËRBLËN PUNËTORËT ME NGA 100 EURO

F. 8

SPORT



BESART BARUTI ZGJIDHET KRYETAR I FEDERATËS SË KARATESË

F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

‘Për të mirën e ShBA-së dhe amerikanëve’, Grenelli në Shtëpinë e Bardhë takon Trumpin

WASHINGTON, 31 JANAR - Ish-emisari për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, pas rikthimit të Donald Trumpit në Shtëpinë e Bardhë, ka marrë një rol të madh në administratë, duke u emëruar emisar presidencial për misione të veçanta. Pas një takimi të përbashkët në Kaliforni, ku Grenelli është paraqitur bashkë me Donald Trumpin në një konferencë për medie,

emisari amerikan ka treguar se të enjten është takuar në Shtëpi të Bardhë me presidentin Trump. “Sapo dola nga takimi në Zyrën Ovale me presidentin Donald Trump. Ai është i fokusuar për atë që është më e mira për Amerikën dhe popullin amerikan”, ka shkruar Grenelli në platformën “X”. Që prej kur e ka marrë detyrën e re, Grenelli ka pasur dy reagime për

Kosovën dhe raportet ShBA - Kosovë. Fillimisht kishte reaguar për deklaratën e kryekuvendarit Glauk Konjufca i cili kishte kritikuar administratat Obama dhe Biden dhe kishte rikthyer një shkrim të Kurtit ku përkrahte presidentin Joe Biden, duke përmendur faktin se gjatë katër vjetëve të fundit raportet Kosovë - ShBA janë çuar në një nivel shumë të ulët.



Gjysma e danezëve e shohin ShBA-në kërcënim, 78 për qind e tyre kundër shitjes së Grenlandës

KOPENHAGË, 31 JANAR - Gati gjysma e danezëve besojnë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) përbëjnë një kërcënim të rëndësishëm për vendin e tyre, më i madh se Koreja e Veriut apo Irani, dhe shumica janë kundër shitjes së Groenlandës, sipas një sondazhi të fundit të Yougov. Sondazhi, i kryer midis 15 dhe 22 janarit dhe që përfshin më shumë se 1 000 njerëz në Danimarkë, tregoi se 46 për qind besojnë se ShBA-ja është ose një “kërcënim shumë i



madh” ose një “kërcënim mjaft i madh” për Danimarkën, ndërsa e njëjta gjë vlen edhe për Korenë e Veriut, konsiderohet nga 44 për qind e tyre, dhe Irani nga 40 për qind, shkruan “The Guardian”. Nga të anketuarit, 78 për qind kanë thënë se kundërshtojnë shitjen e Grenlandës në ShBA, ndërsa 72 për qind besojnë se vendimi përfundimtar duhet të merret në Grenlandë, jo në Danimarkë. Sondazhi u krye pasi

presidenti i ShBA-së, Donald Trump, ka thënë se ShBA-ja duhet të kishte kontroll mbi Grenlandën dhe Kanalin e Panamasë për “sigurinë ekonomike” dhe e përshkroi pronësinë dhe kontrollin e territorit si një “domosdoshmëri absolute”. Grenlanda, një ishull Arktik me një popullsi prej 57 000 banorësh, më parë drejtohej si një koloni nga Danimarka, e cila ende kontrollon politikën e jashtme dhe të sigurisë së ishullit.

Udhëheqësi i ri sirian premton një qeveri kalimtare gjithëpërfshirëse

DAMASK, 31 JANAR - Presidenti i sapoemëruar i Sirisë, Ahmed al-Sharaa, ka thënë se do të formojë një qeveri kalimtare gjithëpërfshirëse që do të përfaqësojë komunitete të ndryshme, do të ndërtojë institucione dhe do ta drejtojë vendin derisa të mbajë zgjedhje të lira dhe të ndershme. Sharaa i është drejtuar kombit në fjalimin e tij të parë që kur është emëruar president për periudhën kalimtare të mërkurën nga fraksionet e armatosura që rrëzuan ish-presidentin sirian Bashar al-Assad në ofensivën e vitit të

kaluar. Grupi i armatosur që udhëhoqi ofensivën, Hayat Tahrir al-Sham, që atëherë ka krijuar një qeveri të përkohshme që ka mirëpritur një numër delegacionesh të larta diplomatike perëndimore dhe arabe, që kanë shprehur gatishmërinë për të ndihmuar në stabilizimin e vendit pas 13 vjetësh luftë civile. Sharaa në fjalimin e tij ka thënë se do të formojë një organ të vogël legjislativ për ta mbushur hendekun parlamentar deri në mbajtjen e zgjedhjeve të reja, pasi parlamenti sirian u shpërnda të mërkurën. Ai ka



thënë se do të njoftojë në ditët në vijim formimin e një komiteti që do të përgatitet për të mbajtur një konferencë kombëtare të dialogut që do të jetë një platformë për sirianët për të diskutuar programin e ardhshëm politik të kombit. Kjo do të pasohet nga një “deklaratë kushtetuese”, ka thënë ai, në një referencë të dukshme ndaj procesit të hartimit të një kushtetute të re siriane. Sharaa ka thënë më parë se procesi i hartimit të një kushtetute të re dhe mbajtja e zgjedhjeve mund të zgjasë deri në katër vjet.

Zbulohet virusi i ri ‘Sindbis’ në Spanjë, transmetohet nga mushkonjat

MADRID, 31 JANAR - Shkencëtarët spanjollë kanë zbuluar një virus të ri të transmetuar nga mushkonjat, virusin “Sindbis”, i cili nuk është fatal, por shkakton simptoma të tilla si ethe, dhimbje koke dhe dhimbje

kyçesh, si dhe skuqje të lëkurës. Shkencëtarët kanë zbuluar virusin te mushkonjat në Andaluzi, dhe ata supozojnë se ai ka qenë në Spanjë që nga viti 2017, por ai nuk ishte zbuluar deri më tani sepse

kërkimet ishin të fokusuara në virusin e Nilit Perëndimor. Ky virus është shfaqur më parë në Skandinavi dhe Algjeri dhe është transmetuar nga mushkonjat nga Afrika e

Veriut ose Kenia te mushkonjat lokale. Sipas medieve ndërkombëtare, ky virus nuk është aq vdekjeprurës sa virusi i Nilit Perëndimor, i cili është i pranishëm edhe në Andaluzi.



Cili është kontributi i ShBA-së në Gjykatën Speciale?

Presidenti amerikan Donald Trump përmes një urdhri ekzekutiv ka ngrirë për 90 ditë ndihmën ndërkombëtare. Ky urdhër ka prekur edhe Gjykatën Speciale, në të cilën janë duke u gjykuar liderët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi. Zëdhënësja e Speciales nuk ka dhënë informacione nëse stafi i gjykatës që vjen nga ShBA-ja preket nga ky vendim ose jo. Ajo ka thënë se ShBA-ja kryesisht kontribuon në financimin e disa punonjësve, por pa dhënë hollësi

PRISHTINË, 31 JANAR - Kontributi i Shteteve të Bashkuara në Dhomat e Specializuara në Hagë kryesisht është i përqendruar në financimin e punonjësve të emëruar nga autoritetet shtetërore. Kështu ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" zëdhënësja e Gjykatës, Angela Griep, kur është pyetur nëse financimi i këtij institucioni do të preket pas pezullimit të përkohshëm të financimit nga ShBA-ja.

Griep nuk ka dhënë informacione nëse stafi i gjykatës, që vjen nga ShBA-ja, preket nga ky vendim ose jo. Presidenti amerikan Donald Trump përmes një urdhri ekzekutiv ka ngrirë për 90 ditë ndihmën ndërkombëtare. Ngrija e financimit të programeve të ndihmës është pjesë e përpjekjes së presidentit amerikan, që t'i përshtatë këto programe me qëllimet e tij të politikës së jashtme.

Por, nuk ka konfirmim nëse ky pezullim prek edhe Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar të Kosovës me seli në Hagë të Holandës.

Këto institucione, që njihen edhe si Gjykata Speciale, hetojnë krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000.

Aktualisht në Hagë po zhvillohen disa gjykime ndaj ish-kryerëve të UÇK-së dhe gjykata, po ashtu, ka shpallur edhe disa vendime dënuese.

Kush e financon Gjykatën Speciale?

Gjykata Speciale financohet nga Bashkimi Evropian, por

edhe nga shtetet e treta kontribuuese, ku bëjnë pjesë Shtetet e Bashkuara, Kanadaja, Norvegjia, Zvicra dhe Turqia. Dhomat dhe Prokuroria e Specializuar aktualisht kanë një buxhet prej 97.1 milionë eurosh, që përfshin periudhën nga 15 qershori i vitit 2023 deri më 14 qershor 2025. I gjithë buxheti është financuar nga BE-ja, por shtete të tjera, po ashtu, kontribuojnë për programe të caktuara. Në këtë kontekst, ShBA-ja kryesisht kontribuon në financimin e disa punonjësve, ka thënë Griep.

Sipas raportit të fundit vjetor të Gjykatës, që i përket vitit 2023,

ShBA-ja renditet e dyta, pas Holandës – shtetit mikpritës të selisë së Gjykatës – sa i përket numrit të punonjësve në Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

Punonjësit e emëruar nga ShBA-ja në poste të ndryshme ofrojnë ekspertizën e tyre në Gjykatën Speciale.

Dhomat dhe Prokuroria e Specializuar punësojnë dy kategori punëtorësh: punonjës të emëruar përmes autoritetit shtetëror (seconded) dhe punonjës të kontraktuar. Por, në Speciale kontribuojnë edhe praktikantë nga shtetet e BE-së dhe shtete të tjera kontribuuese.

ShBA-ja financon punëtorët e saj që janë të emëruar përmes autoriteteve shtetërore.

Në Gjykatën Speciale, këta punonjës, që caktohen të punojnë në Hagë, njëkohësisht mbesin të punësuar edhe në institucionet në ShBA, kryesisht në qeveri, organizata ndërkombëtare apo agjenci të zbatimit të ligjit.

Këta punonjës në përgjithësi, por edhe varësisht nga procedurat e shteteve për emërimin e personelit, shërbejnë në Gjykatën Speciale për të paktën një vit, me mundësi të zgjatjes së shërbimit.

Shpenzimet e tyre, përfshirë pagat, kontributet për sigurime shëndetësore, shpenzimet e udhëtimeve dhe kompensimet e tjera i mbulon shteti që i ka emëruar.

Atyre, po ashtu, në varësi të rrethanave, u paguhen edhe mëditjet.

Në mesin e punonjësve amerikanë janë edhe gjykatës dhe prokurorë të specializuar. Nënkrjetar i gjykatës është amerikan Charles L. Smith III,

ndërkaq kryeprokurore është amerikania Kimberly West, që mori këtë post më 2023.

Gjykatësi Smith, po ashtu, është gjykatësi kryesor në rastin më të madh pranë gjykatës, atë kundër ish-kryerëve të UÇK-së: ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarëve Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli dhe ish-deputetit Rexhep Selimi.

Sipas të dhënave, deri më 31 dhjetor 2023 në Gjykatën Speciale ishin të punësuar 283 persona, prej tyre rreth 30 nga ShBA-ja. Numri i punonjësve të emëruar përmes autoriteteve shtetërore, po ashtu, është rritur më 2023 dhe tre nga ta ishin nga ShBA-ja dhe Zvicra.

Financuesit e Gjykatës Speciale mbulojnë shpenzimet e operimit të këtij institucioni, por edhe financojnë programe dhe aspekte të caktuara të operimit. Për shembull, Norvegjia ka financuar renovimin e ndërtesës së Gjykatës dhe Zvicra, përmes një granti, ka kontribuar në financimin e programit të informimit që nga viti 2018.



Grenelli: Dëshmovë në Departamentin e Drejtësisë para jurisë së madhe kundër Jack Smithit



UASHINGTON, 31 JANAR - I dërguari presidencial për misionet speciale në mbarë botën, Richard Grenell, ka treguar se ka dëshmuar në Departamentin e Drejtësisë kundër ish-kryeprokurorit të Gjykatës Speciale, Jack Smith. "Dëshmovë përpara jurisë së madhe të Jack Smithit", ka shkruar Grenelli në platformën "X".

Sipas Grenellit, prokurorët i kanë thënë atij se nuk duhet të flasë në publik për dëshminë e tij dhënë para jurisë në Departamentin e Drejtësisë.

Grenelli më herët kishte thënë se Jack Smithi ka shkatërruar "njëherë e përgjithmonë" reputacionin e Gjykatës Speciale. "Media duhet të merret me ndjekjen penale të

Hashim Thaçit nga ish-kryeprokurori Jack Smith. Thaçi është ende në burg, megjithatë aktakuza e Jack Smithit është e mbushur me gënjeshtër. Dëshmitarët e rremë tani kanë disa akuza të egra për taktikat e Jackut. Ai ka shkatërruar reputacionin e Hagës", kishte thënë Grenelli para fitores së Donald Trumpit.



Kosova përkujton heroin Zahir Pajaziti me bashkëluftëtarë

EPOKA E RE **Lirim GECI**

PRISHTINË, 31 JANAR - Janë bërë 28 vjet nga rënia heroike e komandantit të UÇK-së, Zahir Pajaziti dhe bashkëluftëtarëve të tij, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha. Ata janë përkujtuar të premten nga përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës, liderët partiakë dhe bashkëluftëtarët e tyre. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e cila ka bërë homazhe te shtatorja e heroit Zahir Pajaziti në Prishtinë, ka thënë se tre heronjtë ishin lajmëtarë të lirisë dhe inspirues të brezave të UÇK-së. Osmani ka thënë se puna me përkushtim ndaj shtetit është nder për secilin hero që ka dhënë jetën për Kosovën. “Nderojmë sot trimërinë dhe guximin e heroit Zahir Pajaziti, i cili me bashkëluftëtarët Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha u bënë lajmëtarë të lirisë sonë, të cilët jo vetëm dhanë jetën për lirinë e Kosovës, por në të njëjtën kohë inspiruan edhe breza të tërë të UÇK-së që t’i bashkohen luftës sonë çlirimtare dhe të luftojnë për

Kosovën, për popullin e saj, për lirinë e kësaj toke deri në çlirimin përfundimtar i cili erdhi në qershor të vitit 1999. Ideali për të cilën luftoi Zahir Pajaziti me shokë, duhet të na shërbejë sidomos në ditët e sotme, sepse liria e sovraniteti nuk janë të mirëqena, ato vazhdimisht duhet të mbrohen e të mirëmbahen, prandaj duke punuar çdo ditë me përkushtim ndaj shtetit tonë e ndaj interesave të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj, ne i bëjmë nder secilit hero që e dha jetën për Kosovë, përfshirë edhe heroin Zahir Pajaziti”, ka thënë Osmani. Edhe kryeministri Albin Kurti ka bërë homazhe te shtatorja e Zahir Pajazitit në kryeqytet.

PKD-ja me bashkëluftëtarë nderon heroin Zahir Pajaziti

Në 28-vjetorin e rënies së heronjve të kombit, Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PKD), Memli Krasniqi, me kolegë dhe bashkëpunëtorë, ka

bërë homazhe te shtatorja e heroit Zahir Pajaziti. Ai ka thënë se Pajaziti, Zejnullahu dhe Hoxha ishin bërë frymëzim për brezat pasues të UÇK-së. “I përrjetshëm është kujtimi për tre luftëtarët e orëve të para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët u bënë burim frymëzimi për brezat pasues të çlirimtarëve në përmbushjen e misionit të popullit tonë për liri e pavarësi. Lavdi veprës dhe sakrificës emblematike të Zahir Pajazitit, Hakif Zejnullahut dhe Edmond Hoxhës!”, citohet të ketë thënë Krasniqi, ka njoftuar PKD-ja. Homazhe te shtatorja e Zahir Pajazitit ka bërë edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj. Pas homazheve, Haradinaj i ka falënderuar të tre heronjtë për kontributin dhe shërbimin ndaj atdheut. “Në kërkim të lirisë dhe të drejtës së shqiptarëve, Zahir Pajaziti, Edmond Hoxha dhe Hakif Zejnullahu, njëzet e tetë vjet më parë u shndërruan në shembuj të atdhedashurisë dhe vetëmohimit, pikëmbështetje të vizionit tonë për Kosovën”, ka thënë Haradinaj. Homazhe te shtatorja e Zahir

Pajazitit kanë bërë edhe organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, ndërsa te varrezat në kompleksin memorial në Orlan ka bërë nderim Koalicioni për Familjen. Më 31 janar të vitit 1997 kishte ndodhur një nga betejat e para madhore të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Tre strategët e lirisë, Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha, ishin duke udhëtuar nga Prishtina në drejtim të Vushtrrisë, derisa grupi i tyre zbulohet nga siguri serb, i cili kishte vënë pritë në fshatin Pestovë të Vushtrrisë, ku të tre bashkëluftëtarët patën rënë heroikisht në luftë me ta. Aktivitetet ushtarake Zahir Pajaziti i kishte filluar gjatë viteve '90. Në rrethanat e krijuara gjatë grevave të përgjithshme në Kosovë të mbajtura më 3 shtator të vitit 1990, Zahir dhe aktivistë të tjerë kishin filluar të punojnë për ngritjen e një rrjeti siguri në Kosovë. Si rezultat i kësaj pune, Zahir dhe aktivistët e Orlanit kishin krijuar Shtabin e Njësisë Guerile në Orlan. Në vitin 1991, pasi që në Kosovë

fillojnë punët e ilegales të koordinoheshin me legalen, Zahir shkoi në Shqipëri për qëllime ushtarake. Pas kthimit në Kosovë në vitin 1992, grupi i tij zbulohet dhe Zahirin i duhet të kalojë në ilegalitet për disa muaj. Deri më 1992 kishte kontribuar në furnizimin me armatim të shtabeve të krijuara në rrethinën e Orlanit. Gjatë vitit 1994 Zahir kishte filluar të angazhohet edhe në pjesë të tjera të Kosovës për krijimin e UÇK-së. Kështu, ai është një nga themeluesit e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe anëtar i tij nga fillimi, nga fillon të bëhet koordinimi i aktiviteteve politike dhe ushtarake. Zahir shquhet në këtë kohë si organizues dhe zbatues i shkëlqyeshëm i sulmeve guerile ndaj forcave serbe në Kosovë, veçanërisht në rajonin e Llapit. Më 31 janar 2008, në 11-vjetorin e rënies, presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, ia kishte akorduar Zahir Pajazitit dekoratën më të lartë shtetërore të Kosovës, Urdhërin Hero i Kosovës.



Qeveria ia jep 100 hektarë për shfrytëzim Ministrisë së Mbrojtjes

Prishtinë, 31 janar - Qeveria e Kosovës ia ka dhënë në shfrytëzim Ministrisë së Mbrojtjes 100 hektarë në Balltavë të Podujevës për ngritje të kapaciteteve të FSK-së. Ministri i Mbrojtjes, Ejup

Maqedonci, ka thënë se pronat e marra në shfrytëzim janë të Agjencisë së Pyjeve të Kosovës dhe do të ndihmojnë në lehtësimin e arritjes së objektivave për investime afatgjatë të FSK-së. “Do të

shfrytëzohet nga Forca e Sigurisë së Kosovës për ngritjen e kapaciteteve operacionale të ushtrisë së Kosovës. Kjo pronë është evidentuar si pronë shoqërore e Agjencisë së Pyjeve dhe e

njëta kërkohet t’i jepet në shfrytëzim Ministrisë së Mbrojtjes me qëllim të arritjes së objektivave për investime afatgjatë për interesa të veçanta në infrastrukturë”, ka thënë Maqedonci.



Njeriu i ri i dialogut: Çfarë mund të presim nga Peter Šorenseni?

PRISHTINË, 31 JANAR - Për herë të parë në pesë vjet, negociatat në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk do t'i ndërmjetësojë Miroslav Lajçak. Bashkimi Evropian (BE) ka vendosur që emisar i tij i ri për dialogun të jetë Peter Šorensen. Zyrtarisht ai nis punën sot (e shtunë) dhe do të merret vetëm me dialogun ndërmjet dy vendeve fqinje, e jo edhe me çështje rajonale të Ballkanit, sikurse paraardhësi i tij. Prej kur ka nisur të lakohet emri i Šorensenit në medie, javë më parë, atmosfera për të ka qenë pozitive.

Një prej argumenteve më të shpeshta ka qenë se 57-vjeçari e njeh rajonin. Dhe, njëmend ashtu është. Diplomati prej shumë vitesh, ai ishte angazhuar në Kosovë, në kuadër të Misionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNMIK), si dhe në role të tjera, në Serbi, Maqedoni të Veriut dhe Bosnjë-Hercegovinë.

Siç kanë thënë edhe njohësit e politikës, ai nuk ka nevojë të informohet paraprakisht për njerëzit apo faktet historike të rajonit, sepse tashmë ka pasur mundësinë ta krijojë një pasqyrë nga afër.

Një tjetër argument që është përmendur si pozitiv nga zyrtarët në Prishtinë është se ai është nga Danimarka, vend që njeh shtetësinë e Kosovës, dhe se do të ketë qasje të barabartë në dialog.

Prejardhja e një ndërmjetësuesi është kthyer në element shumë të rëndësishëm, prej kur atë pozitë e pati marrë Lajçaku, ndërsa atë të kryediplomatit të BE-së e ka mbajtur Josep Borrelli.

Duke qenë njëri nga Sllovakia e tjetri nga Spanja, të dyja vende mosnjohëse të shtetësisë së Kosovës, ata i ka ndjekur vazhdimisht një hije e zezë. Nga qytetari i thjeshtë i Kosovës deri te presidentja e vendit, Vjosa Osmani, dyshja është akuzuar për njëanshmëri dhe për rreshtim, me raste, nga Serbia. Të dy i kanë mohuar



vazhdimisht akuzat.

Ky problem nuk do të ekzistojë tani, por problematike konsiderohet periudha në të cilën Šorenseni nis punën.

Nisur nga zgjedhjet në Kosovë, dhe paqartësitë politike në Serbi – pas dorëheqjes së kryeministrit atje – njohësit e zhvillimeve politike presin pak përparim, sidomos në gjashtë muajt e parë të mandatit të danezit.

Adnan Qerimagiq, analist në Iniciativën Evropiane për Stabilitet, beson plotësisht në përkushtimin e Šorensenit për ta kryer punën e tij, por aq nuk mjafton. “Suksesi i tij në përmbushjen e mandatit do të varet nga qasja e tij, nga konteksti në Kosovë dhe në Serbi. Por, më e rëndësishmja është edhe ajo që BE-ja mund t'i ofrojë për t'ia përforcuar mandatin”, ka thënë ai për “Radion Evropa e Lirë”.

Ministria e Jashtme e Sllovenisë, Tanja Fajon, ka thënë ditë më parë se me zgjedhjen e Šorensenit po dërgohet mesazhi se dialogu mbetet lart në agjendën e bllokut evropian.

Roli i Gjermanisë dhe i Francës

E çfarë ka BE-ja për t'iu ofruar dy vendeve, aktualisht? Pak, për të mos thënë asgjë. “Procesi i zgjerimit është bllokuar. BE-ja nuk ka gatishmëri ta zhblokojë atë tani. Rruga evropiane e Kosovës nuk është duke u trajtuar me seriozitet. Pa i pasur përbërësit kryesorë, secili individ në atë pozitë do ta kishte detyrë jashtëzakonisht të vështirë për ta kryer”, ka vlerësuar Qerimagiq, duke përmendur edhe ngecjet e Serbisë në integritet evropian. Burime të “Radios Evropa e Lirë”

në Bruksel pohojnë se suksesi real në dialog do të varet nga presioni dhe energjia që do të shpenzojnë shtetet kryesore të bllokut evropian mbi dialogun, sidomos Gjermania dhe Franca. Por, ato tani po përballen me kriza të brendshme politike dhe, rrjedhimisht, Šorenseni nuk do ta ketë fuqinë politike mbrapa vetes që, ndoshta, do ta dëshironte. Megjithatë, sipas këtyre zërave, një gjë është e sigurt: Nuk do të ketë kthim mbrapa nga obligimet që kanë bërë Kosova dhe Serbia, dhe ato do të duhet të punojnë për zbatim të marrëveshjeve paraprake.

Marrëveshja e arritur më 2023 në Bruksel për normalizim marrëdhëniesh, dhe një aneks për zbatimin e saj, konsiderohen kryesore për rrugën përpara.

Disa fajësojnë Lajçakun që nuk ka arritur t'i bindë palët për nënshkrimin e saj, ndërsa

mandatin e tij si ndërmjetësues e përshkruajnë më shumë për menaxhim krizash.

Përfshirja amerikane

Një tjetër përcaktues për sukses në dialog ka të bëjë edhe me përfshirjen amerikane. Rëndom, i dërguari i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor ka ofruar mbështetje për këtë proces. Këtë pozitë aktualisht e mban Alexander Kananof. Nëpër deklarime publike ai u ka bërë thirrje të dyja palëve t'i përmbushin të gjitha angazhimet që kanë marrë përsipër. Obligimet e tyre datojnë prej vitesh. Palët negociojnë qysh prej vitit 2011 dhe kanë arritur një mori marrëveshjesh, por jo të gjitha janë zbatuar. BE-ja ua rikujton të dyja palëve shpesh se avancimi në procesin e dialogut është i lidhur me rrugën e tyre drejt integriteteve euroatlantike.

Kosova ndan gjysmë milioni euro për palestinezët në Gazë

PRISHTINË, 31 JANAR - Qeveria e Kosovës ka ndarë gjysmë milioni euro ndihmë humanitare për palestinezët në Gazë, pas arritjes së armëpushimit më herët gjatë këtij muaji, që ndali luftën 15-mujore në enklavën palestineze.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se armëpushimi i arritur në mes të Izraelit dhe Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - mundëson dërgimin e ndihmave në Gazë. “Qeveria shpreson dhe bën thirrje që ky

armëpushim i përkohshëm të shfrytëzohet për arritjen e paqes së qëndrueshme, pra paqe të drejtë dhe të bazuar në zgjidhjen me dy shtete”, ka thënë Kurti.

Kurti ka thënë se lufta në Gazë ka shkaktuar viktima të shumta dhe dëme materiale, andaj palestinezëve u duhet ndihma nga shtetet e tjera që të “mbijetojnë dhe rindërtojnë vendin e tyre”.

Më 19 janar hyri në fuqi armëpushimi në mes të Izraelit dhe Hamasit, duke mundësuar lirin e pengjeve që mbahen në Gazë në këmbim të të burgosurve palestinezë në



Izrael, por edhe dërgimin e ndihmave humanitare dhe kthimin e palestinezëve në shtëpitë e tyre.

Lufta e ka detyruar popullsinë

prej 2.3 milionë banorësh të zhvendoset nga shtëpitë e tyre, shpesh më shumë se një herë, dhe ka shkaktuar shkatërrime të mëdha në enklavë.

Një vlerësim i dëmeve, i bërë nga Kombet e Bashkuara i publikuar këtë muaj, ka treguar se pastrimi i mbi 50 milionë tonë rrënojave të mbetura si pasojë e bombardimeve të Izraelit, mund të zgjasë 21 vjet.

Lufta në Gazë ka nisur pasi më 7 tetor Hamasi kishte sulmuar Izraelin, duke vrarë rreth 1 200 persona, shumica civilë, dhe duke rrëmbyer afër 250 të tjerë. Si pasojë e ofensivës izraelite, në Gazë janë vrarë më shumë se 47 000 palestinezë, shumica gra dhe fëmijë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në enklavën palestineze.

Legjitimiteti moral përballë legjitimitetit politik

(Kumtesë e lexuar me rastin e shënimit të 26-vjetorit të rënies së dëshmorëve të kombit, Pren dhe Memë Lleshi, në Goden të Hasit, më 28.01.1999)



Arben HOXHA

Në historinë e kombit shqiptar institucioni i familjes nuk është vetëm një fakt sociologjik i pranisë shoqërore. Është më shumë se kaq: familja është përfaqësim identitar i vullnetit për formimin e kombit shqiptar, si subjekt historik. Familjet princore arbërore: Kastriotët, Topiajt, Arianitët, Muzakajt, Balshajt etj., nuk ishin vetëm familje sundimtare, por simbol i vazhdimësisë së ekzistencës së arbërorëve. Familja e frashërlinjve janë mishërim i vizonit shpirtëror, moral, kulturor e politik të shqiptarëve si subjekt, jo pësues e konsumues të historisë, por prodhues e ndërtues të saj. Në historinë tonë më të re, familjet Jasharaj, Haradinaj dhe Lleshi nga Vraniqi i Gjakovës, me sakrificën e tyre për liri, e bënë të dukshme atë që e kishte ruajtur të pakontaminuar koraca e shpirtit shqiptar: vullnetin për liri dhe përmasën e dinjitetit njerëzor. Familjet princore arbërore, me fuqinë e legjitimitetit të tyre të trashëguar, e kishin të drejtën dhe forcën për të mobilizuar pjesëtarët e principatave të tyre për mbrojtje nga armiqët e tyre. Familja Jashari, Haradinaj dhe Lleshi nuk e kishin privilegjin e familjeve princore arbërore; ato nuk e kishin as legjitimitetin e trashëguar e as legjitimitetin e krijuar përmes “votës së lirë e demokratike” nën pushtimin e egër serb. Ato e krijuan legjitimitetin e tyre moral përmes etikës së virtytit të vetëflijimit. Liria dhe sakrifica janë binom i pandarë. Sakrifica është përmbajtja dhe kushti i shfaqjes së lirisë; bartësja dhe konservuesja e vlerës së saj. Perëndia provën e vet të dashurisë dhe mirësisë që ka ndaj njerëzimit, me qëllim që ta çlirojë nga mëkati fillestar i trashëguar nga Adami, e dha duke sakrifikuar pjesën më vitale nga trinia e qenies së vet: Jezu Krishtin. Flijimi i Jezu Krishtit është vullneti Hyjnor për

vetëtejkallim nga imanenca në transcendencë, me qëllim që qenia njerëzore të ngrihet në një stad më të lartë moral. Vetëtejkallimi, si akt i bërjes, kalon përmes sakrificës. Përballja me vdekjen është vërtetësia dhe kushti i vetëtejkallimit. Gatishmëria për t’u përballur me vdekjen është absolutja e vullnetit të të mëdhenjve. Për të mëdhenjtë ajo është detyrë dhe përgjegjësi për kthimin e të pamundurës në të mundurën; prandaj e zakonshme; për të vegjlit ajo është e jashtëzakonshme, sepse është jashtë domenit të vullnetit të përgjegjësisë dhe detyrës që iu imponon përditshmëria e tyre e zakonshme. Sot, në lokalin “Dasmori”, jemi tubuar jo për të përkujtuar, por për t’u përlulur para “dasmorëve” të lirisë: dëshmorëve të kombit Pren e Memë Lleshi dhe sakrificës së gjithë familjes së Markalleshëve të Vraniqit të Gjakovës. Familja Lleshi, ashtu si ajo e Jasharajve dhe Haredinajve, me vullnetin e tyre për t’u përballur me vdekjen përmes vetëflijimit, krijuan kushtet që populli shqiptar të ngrihet nga gjendja e skllavërisë në gjendjen e lirisë. Në luftën e UÇK-së janë dy momente të rëndësishme që i japin karakter emblemantik luftës së familjes Lleshi kundër forcave serbe: rezistenca e armatosur e 7 gushtit të 1998-ës e tërë familjes Lleshi (burra e gra), dhe angazhimi i vëllezërve Lleshi në logjistikë për furnizim me armë e municione pas ofensivës së dytë të madhe të forcave serbe në Zonën Operative të Dukagjinit. Ishin vëllezërit Lleshi, të cilët, që në kushtrimin e parë për luftë kundër forcave serbe, u angazhuan në logjistikë për armatosjen e fshatrave të Dushkajës. Brutaliteti i egër i forcave serbe gjatë pranverës dhe fillimit të verës së 1998-ës fshatrave të Dushkajës, bëri që popullata e kësaj ane të humbë besimin në luftë. Për rrjedhojë do të ndodhë edhe procesi i demobilizimit e i dorëzimit të armëve, të atyre armëve, të cilat me mund e sakrifika të madha i kishin siguruar vëllezërit Lleshi. Në këtë proces demobilizimi, u dekonspirua edhe aktiviteti i familjes Lleshi. Për pasojë, më 7 gusht 1998, ndodh rrethimi i familjes Lleshi nga forcat serbe, rrethim i cili përbën një variant të rrethimit të Familjes Jashari dhe asaj Haradinaj. Një familje e

vetëm, pa mbështetje nga askush, në pikën më të ulët të moralit të popullatës për luftë, kishte dy zgjidhje: dorëzimin e armëve (si të tjerët) ose rezistencën e armatosur deri në flijim. Familja Lleshi, me gra e burra, vendosën për të pamundurën, sepse e pamundura ishte vendndodhja dhe kuptimi i ekzistencës së tyre: vendosën për rezistencë. Qëndrueshmëria në guxim është vërtetësia morale e besimit në liri. Me rezistencën e tyre, Familja Lleshi dëshmoi se besimi i saj nuk ishte aksidental, por substanca e ekzistencës së tyre. Momentin i dytë që manifeston forcën e vullnetin për liri të familjes Lleshi e shënjon situata pas ofensivës së dytë në ZOP të Dukagjinit. Pas dezertimit masiv, kur në Zonën Operative të Dukagjinit kishin mbetur më pak se 50 luftëtarë të komanduar nga Ramush Haradinaj dhe lëvizjet për Shqipëri ishin të pamundura; kur shanzherët e armëve të ushtarëve UÇK-së ishin të boshatisur, ishin vëllezërit Lleshi ata që ia dolën të çajnë rrethimi, jo rrethimin fizik, por rrethimin nga e pamundura për të siguruar municione e armatime për ushtarët, por edhe për t’i bartur të plagosurit drejt Shqipërisë për shërim. Sakrifika e familjes Jashari shënjon ndërprerjen e paradigëmës etike “çfarë duhet të bëhemi” dhe fillimin e jetësimit të paradigëmës “çfarë duhet të bëjmë”. Paradigma e parë

përfaqëson etikën e legjitimiteti politik, e cila bazohet në kriterin e vërtetësisë procedurale; paradigma e dytë përfaqëson etikën e legjitimitetin moral, e cila bazohet në kriterin e justifikimit moral të gatishmërisë për vetëflijimi. Sakrifika e Jasharajve përbën aktin e ndërprerjes së zinxhirit shkakor të racionalitetit të paradigëmës “çfarë duhet të bëhemi”. Rezistenca e Haradinajve më 24 mars 1998 dhe rezistenca e familjes Lleshi nga Vraniqi i Gjakovës më 7 gusht 1998 janë vazhdimësia e ndërprerjes së rezistencës paqësore që do të sjellë akti i flijimit të Jasharajve. Rënia e Familjes Jashari është ngjarja në kohë jashtë rrjedhjes së zakonshme të kohës. Më 7 gusht 1998, Familja Lleshi dëshmoi se kalimi nga gjendja e robërisë në gjendjen e lirisë e të dinjitetit njerëzor është i mundur vetëm përmes ndërlidhjes së etikës deontologjike të përgjegjësisë ndaj detyrës që i shtronte historia popullit shqiptar dhe etikës së virtytit për të sakrifikuar jetën në përgjigje të thirrjes për përmbushjen e asaj detyre. Ngërçi dhe errësimi i vetëdijes politike shqiptare sot është pasojë e luftës për supremaci të legjitimitetit politik kundrejt legjitimitetit moral. Lufta e UÇK-së, ashtu sikur dje, edhe sot nuk rresht së trajtuar, jo si ngjarje, por si një hallkë brenda zinxhirit të kauzalitetit të racionaliteti të paradigëmës “çfarë duhet të bëhemi”. Brenda hallkave të

këtyre zinxhirëve, në mos e paqenë, ajo pretendohet të bëhet krejt e zakonshme. Ajo trajtohet herë si vazhdimësi organike e herë si aspekt komplementar i rezistencës paqësore për liri. Lufta e UÇK-së nuk është as vazhdimësia e as komplementarja e rezistencës paqësore. Legjitimisti politik, Ibrahim Rugova, ashtu siç do të deklarojë vetë në Hagë, për ta ruajtur veten dhe familjen – i dorëzuar - nga Millosheviqi do të kërkojë largimin e tij nga Kosova. Adem Jashari duke refuzuar dorëzimin do të flijohet bashkë me 59 anëtarët e familjes së tij. Nuk mund të jenë komplementare dy logjika përjashtuese përballë rrezikut të vdekjes: njëra që bazohet në parimin moral të ruajtjes së jetës edhe me kushtin e nënshtrimit e poshtërimit dhe tjetra që bazohet në parimin e mohimit të jetës në emër të mbrojtjes së vlerës së dinjitetit njerëzor e kombëtar. Lufta e UÇK-së është shpërthim më efektiv i risisë së paparashikueshme e të pakontrollueshme kundrejt rezistencës paqësore. Ajo është treguesi kufitar i ndërprerjes së idesë së lirisë dhe lëvizësi i zhvillimit të saj. Legjitimiteti moral që del nga sakrifika përballë dhe në vdekje, në raport me lirinë, e pamundëson gjasën e gabueshmërisë; legjitimiteti politik përmes votës, përherë është nën rrjetin e gjasave të gabueshmërisë. Për luftëtarin e lirisë gjasa është thellësisht e rrënjësor në aktualitetin e marrëdhënies morale të ekzistencës së tij me lirinë. Vetëm ashtu sakrifika bëhet detyrë e zakonshme për të. Për legjitimistët politikë, gjasa është vetëm një abstraksion matematikor në marrëdhënie me fuqinë e pushtetit politik në të ardhmen. Legjitimiteti moral, i dalë nga sakrifika, nuk mund të jetë aspekt komplementar i legjitimitetit politik e as vazhdimësi e tij. Legjitimiteti politik është singular; legjitimiteti moral është universal. Legjitimiteti politik është i përkohshëm; legjitimiteti moral është i tejkohshëm. Dëshmorët e lirisë janë të gjithëkohshëm. Të tillë janë dëshmorët Pren e Memë Lleshi. Lavdi e përjetshme Mark, Kolë, Pren e Memë Lleshi! Lavdi sakrificës së Familjes Markalleshi! Lavdi gjithë dëshmorëve të kombit!



Siguria në veri, ushtarët turq të KFOR-it patrullojnë në vijën kufitare me Serbinë

Prishtinë, 31 janar - KFOR-i përmes një njoftimi për medie ka bërë me dije për një kontroll rutinor që forcat

turke kanë kryer sot në disa lokalitete në veri të Kosovës për të siguruar siguri përgjatë vijës kufitare në mes të

Kosovës dhe Serbisë. “Këto përpjekje janë pjesë e përpjekjeve të përditshme të misionit të KFOR-it për të

garantuar ambient të qetë dhe të sigurt për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë”, ka njoftuar KFOR-i.



Murseli deklarohet i pafajshëm për vrasjen e Liridona Ademajt, Dodaj dënohet për shitjen e armës

PRISHTINË, 31 JANAR - Në seancën fillestare për vrasjen e Liridona Ademajt, bashkëshorti i saj është deklaruar “plotësisht i pafajshëm” për akuzën “vrasje e rëndë”, teksa prokuroria ka dhënë hollësi rreth aktakuzës dhe ka thënë se Murseli e kishte planifikuar vrasjen e bashkëshortes së tij. I akuzuari tjetër, Kushtrim Kokalla, ka thënë se nuk deklarohet pa u konsultuar me avokatin, ndërsa Granit Plava ka thënë se zgjedh të mbrohet në heshtje, kurse Tomë Dodaj e ka pranuar fajësinë. Dodaj ishte përfshirë në akuzë, pasi i ka shitur armën Murselit, me të cilën ishte kryer vrasja e Liridona Ademajt. Ai më pas është dënuar me pesë vjet burgim dhe 5 000 euro gjobë. Për veprën penale ai mund të dënohej deri me tetë vjet burgim. Gjatë shqiptimit të aktgjykimit, gjykatësja bëri me dije se rasti ndaj Dodajt do të ndahet nga rasti ndaj tre të akuzuarve të tjerë për vrasjen e Liridona Ademajt. Pas përfundimit të seancës, avokati i tij, Agron Kuçi, ka thënë se Dodaj nuk i kishte njohur paraprakisht të pandehurit, por e kishte kuptuar se armën që e kishte shitur ishte përdorur për vrasje, vetëm pas publikimit në medie të rastit të vrasjes së Liridonës. Kuçi ka thënë se dënimi prej pesë vjetësh burgim është i lartë dhe i njëjti do të apelohej. Liridona Ademajt, 30 vjeçe, është vrarë më 29 nëntor 2023 në një rrugë në fshatin Bërnice të Prishtinës. Rasti fillimisht ishte raportuar si “grabitje me pasojë të vrasjes”, por dy ditë më vonë autoritetet kishin arrestuar dy persona. Në mesin e tyre ishte edhe bashkëshorti i Liridonës, Naim Murseli. Gjyqtarja e rastit, Fatime Dermaku, gjatë seancës që ka zgjatur mbi dy orë, ka thënë se nëse gjenden fajtorë Naim

Murseli, Granit Plava dhe Kushtrim Kokalla, mund të dënohen nga 10 vjet e deri me burgim të përjetshëm. Seanca fillestare për këtë rast ishte paraparë të mbahej më 27 janar, por ishte ndërprerë pak pasi kishte nisur për shkak se avokatët e dy të akuzuarve kishin thënë se nuk kishin pranuar me kohë shkresat e lëndës. Të premten në gjykatore prokuroria ka lexuar aktakuzën ndaj të pandehurve. Aty është thënë se Naim Murseli kishte premtuar 30 000 kompensim për vrasjen e bashkëshortes së tij, Liridonës, madje e kishte mbajtur me njërin dorë, që ajo ta mos shmangte plumbin. Doras, sipas aktakuzës, ishte Granit Plava, ndërkaq Kokalla ishte ai që kishte gjetur Plavën për të kryer këtë akt. Duke folur për pjesën e aktakuzës ndaj Naim Murselit, prokurorja Javorka Përlinçeviq, a thënë se Murseli kishte bërë plan për ta vrarë Liridonën nga mllefi dhe në shenjë hakmarrjeje, pasi çifti kishte pasur “raporte të çrregulluara familjare dhe martesore”. Prokuroria ka thënë se më 25 qershor 2022 është paguar polica e sigurimit jetësor për Liridonën në vlerë prej 3 000 000 kruna suedeze me qëllim që pas vdekjes së saj, Murseli të përfitonte këtë sigurim. Prokuroria ka thënë se Naim Murseli ia ka shpalosur planin e tij të akuzuarit Kushtrim Kokalla për vrasjen e bashkëshortes dhe ka kërkuar nga ai të gjejë mënyra për ta realizuar atë. Ai, sipas Prokurorisë, nuk kishte pranuar të kryente vrasjen, dhe e kishte njoftuar Murselin me Granit Plavën. Prokuroria tha se të tre më pas janë pajtuar që Plava ta vraste Liridonën dhe Murseli do ta kompensonte 30 000 euro. Ndërkaq, në këtë rast Tomë Dodaj është përfshirë pasi në



ditën e vrasjes, Murseli kishte blerë nga ai një pistoletë, e firmës “Zastavë” dhe 20 fishekë, në vlerë prej 280 eurosh. Me këtë armë, prokuroria ka thënë se ishte vrarë Liridona Ademajt. Vrasja, ka thënë prokuroria, është kryer në intervalin kohor nga 19:00 deri në 20:18, në Bërnice të Prishtinës, përkatësisht në vendin e dakorduar mes tre të akuzuarve, të cilët është thënë se kanë inskenuar skenën e krimit me qëllim që të dukej si grabitje. “... Naimi në mënyrë dinake me dorën e tij të djathtë ka mbajtur Liridonën për krahun e dorës së saj të majtë, me qëllim që ajo mos t'i shmangte plumbin, pas çka Naimi me fëmijët kanë dalë nga vetura dhe është larguar nga vendi i ngjarjes”, ka thënë prokuroria. Sa i përket të pandehurit të dytë, Granit Plavës, në aktakuzë përshkruhet si personi që ka shtënë me një plumb drejt Liridonës. Sipas prokurorisë, në Bërnice, në vendin ku paraprakisht ishin marrë vesh me Murselin për ta kryer vrasjen, ky i fundit, teksa po udhëtonte me veturën ku gjendej viktima dhe dy fëmijët e çiftit, i ka bërë shenjë me dritat e veturës Plavës. “Ai më pas ka dalë para veturës me maskë në kokë dhe pistoletë në duar. Ndërkaq, Naim Murseli ka ndaluar dhe e

ka fikur motorin dhe e ka mbajtur me dorë Liridonën. Granit Plava, për kompensim në shumë prej 30 000 eurosh, nga afërsia e drejtpërdrejtë, përmes dritares gjysmë të hapur nga ana e pasagjerit, ka shtënë dhe e ka qëlluar në kokë Liridonën, në pjesën prapa veshit të majtë, duke i shkaktuar plagë vdekjeprurëse dhe për pasojë ka vdekur në vendin e ngjarjes”, ka thënë prokuroria. Autoritetet kanë thënë se gjatë bastisjeve në shtëpinë e tij është gjetur pistoletë “Zastava” dhe 19 fishekë, armë me të cilën Prokuroria tha se është kryer vrasja. Ndërsa Kushtrim Kokallës, sipas autoriteteve, i ishte kërkuar nga Murseli të gjejë “mundësi” për vrasjen e Liridonës dhe ai e kishte njoftuar atë me Plavën. Autoritetet e akuzojnë se ishte në dijeni për vrasjen e Liridonës dhe nuk i kishte lajmëruar autoritetet për këtë vepër penale. Në nisje të seancës të premten, sërish ka pasur ankesa nga një avokat mbrojtës se kishte pasur vështirësi në qasje në shkresat e lëndës. Gjyqtarja Fatime Dermaku ka njoftuar se më 30 janar ka pranuar një e-mail nga Ndrec Dodaj, avokat i Kushtrim Kokallës, i cili ka thënë se CD-të e pranuar për lëndën nuk i janë hapur. Ajo i kishte kërkuar

t'i merrte këto materiale në seancë. Gjatë seancës është ftuar IT-ja i gjykatës, i cili i ka hapur katër CD-të që kishte avokati Dodaj. Gjyqtarja ka thënë se me këtë konstatohet se materialet janë në rregull dhe se të njëjtat u janë dërguar palëve. Ajo shtoi se me këtë konstatohet se prokurori i shtetit ka përmbushur të gjitha detyrimet sa iu përket materialeve. Më pas gjyqtarja ka vazhduar leximin e të drejtave të të akuzuarve. Edhe këtu pati një situatë mes avokatit Dodaj dhe gjyqtarës, pasi Kushtrim Kokalla ishte i vetmi i akuzuar që nuk është deklaruar se nuk i kuptonte të drejtat e tij që ia lexoi gjykatësja. Avokati Dodaj ka kërkuar konsultim me klientin e tij, por gjykatësja Fatime Dermaku ka thënë se po i drejtohej të akuzuarit, duke i kërkuar avokatit të mos pengonte procedurën. Gjykatësja më pas i ka shqiptuar vërejtje me shkrim avokatit të Kokallës dhe e ka paralajmëruar se herën e ardhshme do ta dënojë me gjobë. Me sjelljen e gjykatësës ndaj avokatit Dodaj nuk është pajtuar ekipi mbrojtës i Naim Murselit. Gjykatësja ka shqiptuar një gjobë prej 500 eurosh ndaj mbrojtësit të Murselit, Shemsedin Piraj, për prishje të rendit dhe qetësisë. Përveç të akuzuarve, në sallën e gjyqit kanë qenë të pranishëm edhe babai dhe vëllai i Liridonës. Tomë Dodaj, që është dënuar për shitjen e armës me të cilën është kryer vrasja, ishte i vetmi që u pa nga mediet duke u futur në gjykatore para se të niste seanca. Të pandehurit e tjerë ishin futur brenda Gjykatës Themelore në Pallatin e Drejtësisë nga një hyrje tjetër, larg medieve. Megjithatë, pak para nisjes së seancës, ata janë sjellë me masa të shtuara sigurie brenda sallës së gjyqimit.

Ndahen 2.3 milionë euro për subvencionimin e 244 specialistëve me vetëfinancim



PRISHTINË, 31 JANAR - Qeveria e Kosovës do t'i mbulojë shpenzimet e shkollimit për specialistët. Në mbledhjen e qeverisë është miratuar shuma prej 2.3 milionë eurosh për pagesë të 244 specialistëve me vetëfinancim në periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2025. Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, në një konferencë për medie ka thënë se nga 20 vendime të marra në mbledhjen e qeverisë, dy prej tyre kanë të bëjnë me ndihmën konkrete dhe direkte për specialistët tanë në

Republikën e Kosovës, por edhe specialistët e tjerë shqiptarë nga trojet jashtë Kosovës. “Me propozimin e MSh-së qeveria miratoi vlerën prej 2 milionë e 365 mijë eurosh për subvencionimin e 244 specialistëve prej datës 1 janar deri më 31 dhjetor të vitit 2025. Edhe pse me vetëfinancim, qeveria ka vlerësuar se ndihma ndaj këtyre specialistëve është e domosdoshme, në mënyrë që, përveç investimeve të tjera që po bëjmë për ta mbajtur personelin shëndetësor në Kosovë, të jetë

dhe kjo një ndihmë, t'u mundësohet një shkollim dinjitoz specialistik. Sot u mor edhe një vendim tjetër edhe për 30 specialistë me vetëfinancim jo vetëm nga Lugina e Preshevës, por dhe Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Republika e Shqipërisë u është mundësuar ky shkollim specialistik dhe me këtë ne po eliminojmë padrejtësi. Edhe këtyre specialistëve do t'u ofrohen kushte të barabarta me subvencionimin për shkollimin e tyre specialistik”, ka thënë Vitia.

Pak ditë para zgjedhjeve, Posta shpërblen punëtorët me nga 100 euro

PRISHTINË, 31 JANAR - Bordi i Postës së Kosovës, i emëruar nga qeveria Kurti, ka vendosur të shpërblejë rreth një mijë punëtorë me nga 100 euro secili. Ky vendim është marrë vetëm disa ditë para mbajtjes së zgjedhjeve. “Bordi i Drejtorëve, pas mbledhjes së rregullt të mbajtur më 23.01.2025, ka shqyrtuar pikën ‘Shqyrtimi i dhënies së bonusit për punëtorët e Postës së Kosovës’. Pas vlerësimit të zhvillimeve

pozitive në ndërmarrje, progresit të arritur deri më tani dhe proceseve që priten të realizohen në të ardhmen, si dhe duke marrë parasysh faktorë të rëndësishëm si inflacioni dhe rritja e kostove të jetesës, kryeshefi ekzekutiv ka propozuar dhënien e një bonusi për të gjithë punëtorët e ndërmarrjes. Bordi i Drejtorëve, duke shqyrtuar këtë propozim dhe duke marrë parasysh mundësitë financiare të



ndërmarrjes, ka miratuar dhënien e një bonusi prej 100 euro bruto për të gjithë



punëtorët që kanë thënë në komunikatën e marrëdhënie pune të Bordit të Postës së rregullt dhe aktive”, është Kosovës.

‘CEFTA ka dëshmuar se është partnere kyçe në integrimin e rajonit në tregun unik të BE-së’

BEÇIQ, 31 JANAR - Sekretariati i Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) ka marrë pjesë në konferencën e nivelit të lartë mbi integrimin ekonomik rajonal, mbajtur më 27-28 janar 2025 në Beçiq të Malit të Zi. Konferenca me temën “Fuqizo, integro, rritu” ka mbledhur së bashku vendimmarrës të lartë, zyrtarë të BE-së, drejtues biznesesh dhe ekspertë rajonalë për të diskutuar për përpimin dhe sfidat e bashkëpunimit ekonomik rajonal, me fokus në rrugën e rajonit drejt integrimit në tregun unik të BE-së. Drejtoresha e përkohshme e sekretariatit të CEFTA-s, Danijela Gačević, ka marrë pjesë në panelin “Duke ecur përpara – mbështetja e integrimit rajonal dhe integrimit me BE-në”. Gjatë fjalës së saj, Gačević, ka theksuar rolin kyç të CEFTA-s në nxitjen e bashkëpunimit tregtar, eliminimin e pengesave tregtare dhe reformat që përafrojnë rajonin me standardet dhe prioritetet e BE-së. “CEFTA ka dëshmuar se është



partnere kyçe në integrimin e rajonit në tregun unik të BE-së. Përpjekjet tona tashmë kanë sjellë përfitime konkrete për bizneset dhe qytetarët në Ballkanin Perëndimor, dhe diskutimet e sotme nxorën në pah arritjet tona dhe hapat e ardhshëm. Synimi ynë është të

ndërtojmë një rajon të ndërlidhur dhe të harmonizuar me standardet e BE-së, i gatshëm për të përfutur nga mundësitë e tregut unik”, ka thënë ajo. Konferenca ka trajtuar temat kryesore të bashkëpunimit ekonomik rajonal përmes

sesioneve interaktive: - Zbatimi i planit të ri të rritjes – diskutimi mbi prioritetet dhe strategjitë për përafrimin e Ballkanit Perëndimor me standardet e BE-së. - Avancimi i integrimit tregtar – paraqitja e reformave të politikave dhe shembujve të

suksesit në lehtësimin e tregtisë. - Promovimi i bashkëpunimit rajonal – theksimi i arritjeve në ndërtimin e një tregu të përbashkët rajonal konkurrues dhe të qëndrueshëm. Gjatë kësaj konference janë vënë në pah marrëveshjet e fundit të miratuara nga CEFTA si hapa të rëndësishëm në avancimin e tregut të përbashkët rajonal. Këto përfshijnë marrëveshje mbi tregtinë elektronike, shpërndarjen e pakove, heqjen e bllokimeve gjeografike, njohjen e programeve AEO, menaxhimin e rreziqeve dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke demonstruar përkushtimin e CEFTA-s për të krijuar mundësi të reja për bizneset dhe qytetarët në rajon. “Puna jonë nuk ka përfunduar. Integrimi i plotë në BE kërkon përkushtim dhe inovacion të vazhdueshëm. CEFTA mbetet e përkushtuar për të krijuar një mjedis ekonomik ku bizneset lulëzojnë, qytetarët përfitojnë nga mundësi më të mëdha dhe rajoni forcon partneritetin e tij me BE-në”, ka thënë Gačević.

Murati i fton punëtorët të paraqesin ankesë nëse kompanitë nuk zbatojnë vendimin për pagën minimale



PRISHTINË, 31 JANAR - Ministri i Financave, Hekuran Murati, në një konferencë për medie ka folur rreth zbatimit apo jo të vendimit për pagën minimale prej 350 eurosh nga

kompanitë private. Ai ka thënë se paga minimale është në fuqi që nga viti i kaluar dy euro për orë punë apo 350 euro për punë me orar të plotë dhe kushdo që nuk

paguhet me këtë masë, sipas vendimit për pagën minimale, duhet të paraqesë ankesë. Murati ka thënë se janë të gatshëm t'i marrin masat dhe veprimet, ashtu siç e

parasheh ligji por që, sipas tij, duhet marrë edhe njoftimi përkatës për të gjithë ata që nuk e marrin pagën sipas formatit të miratuar për pagën e re minimale.

Qeveria miraton buxhetin e komunës së Prishtinës

PRISHTINË, 31 JANAR - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka njoftuar se Qeveria e Kosovës ka miratuar buxhetin e komunës së Prishtinës. Ai ka

thënë se këtë vendim do ta përcjellin në Kuvendin e Kosovës. “Siç e dini gjatë vitit të kaluar në afate të rregullta Asambleja Komunale nuk ka arritur që ta miratojë me kohë

buxhetin, prandaj tek tani që e kanë miratuar ne si qeveri e procedojmë për në Kuvend dhe i mbetet legjislaturës së ardhshme në vijim që të miratojë këtë buxhet. Por, deri

atëherë komuna do të vazhdojë me ndarjet buxhetore siç e parasheh ligji, pra sipas vitit 2024”, ka thënë Murati në një konferencë për medie.



Si do të jetë bota pas 5 vjetësh me Inteligjencën Artificiale


Inteligjenca Artificiale (IA) është duke revolucionarizuar çdo aspekt të jetës sonë. Nga arsimiti te shëndetësia, nga ekonomia te argëtimi, kjo teknologji po bëhet një mjet i pandashëm i përditshmërisë. Brenda pesë viteve të ardhshme, ndikimi i saj do të jetë edhe më i madh, duke prekur thellësisht mënyrën se si jetojmë, punojmë dhe ndërveprojmë me njëri-tjetrin. Po cilat janë disa nga transformimet kryesore që priten deri në vitin 2029.

Arsimi: Nga mësimi tradicional te inteligjenca e personalizuar

Në botën e arsimit, IA po riformëson mënyrën se si studentët mësojnë. Në vend të një metode uniforme të mësimdhënies, teknologjia do të mundësojë një përvojë të personalizuar për çdo student. Algoritmet e IA-së do të identifikojnë nevojat dhe dobësitë individuale të nxënësve, duke ofruar materiale dhe ritëm të përshtatur për secilin. Profesori nuk do të zhduket, por do të ketë rolin e një mbikëqyrësi dhe mentori që do të ndihmojë në interpretimin dhe përforsimin e njohurive të marra nga sistemet e automatizuara. Në shumë shkolla, tashmë përdoren platforma të bazuara në IA që ndihmojnë studentët të kuptojnë konceptet më mirë përmes simulimeve dhe analizave të thelluara. Brenda pesë viteve të ardhshme, është e pritshme që shkollat të përdorin më shumë mësues virtualë dhe të ndjekin një model hibrid mësimor.

Shëndetësia: Diagnoza më të saktë dhe trajtime të personalizuara

Në fushën e shëndetësisë, IA do të luajë një rol vendimtar në përmirësimin e diagnozave dhe trajtimeve. Brenda pesë viteve, teknologjia do të mund të analizojë të dhënat mjekësore në mënyrë të menjëhershme dhe të sugjerojë trajtime të personalizuara për pacientët. Ky zhvillim do të ndihmojë në reduktimin e gabimeve mjekësore dhe do të përmirësojë efikasitetin e shërbimeve shëndetësore.



Për më tepër, përdorimi i IA-së në kërkimin farmaceutik do të përshpejtojë procesin e zhvillimit të ilaçeve të reja. Përmes analizave të avancuara të të dhënave, do të jetë më e lehtë të gjenden trajtime efektive për sëmundje të ndryshme, duke reduktuar ndjeshëm kohën dhe kostot e zhvillimit të tyre.

Ekonomia dhe tregu i punës: Riformësimi i mënyrës së punës

Ekonomia do të përjetojë një transformim rrënjësor, pasi shumë procese do të automatizohen. Industria financiare tashmë po përdor algoritme të IA-së për të optimizuar investimet dhe për të luftuar mashtrimet financiare. Në të njëjtën kohë, sistemet e IA-së do të ndihmojnë bizneset të analizojnë sjelljen e konsumatorëve dhe të ofrojnë produkte dhe shërbime të personalizuara. Megjithatë, automatizimi i punës do të çojë në humbjen

e disa vendeve të punës, sidomos në sektorë si bankat, sigurimet dhe shërbimet administrative. Nga ana tjetër, do të krijohen profesione të reja që kërkojnë aftësi në menaxhimin dhe zhvillimin e teknologjisë së IA-së. Sipas një raporti të fundit, deri në vitin 2029, rreth 3.8 milionë vende pune në Itali pritet të zëvendësohen nga inteligjenca artificiale, ndërkohë që do të krijohen mundësi të reja në sektorë të ndryshëm si inxhinieria e të dhënave dhe etika e IA.

Automjetet dhe transporti: Drejtimi autonom

Në pesë vitet e ardhshme, makinat autonome do të jenë më të përhapura. Sistemet e IA-së do të mund të analizojnë kushtet e trafikut dhe të marrin vendime në kohë reale për të reduktuar aksidentet. Me përmirësimin e sensorëve dhe algoritmeve të vetë-mësimit, këto automjete do të jenë në gjendje të lëvizin me siguri

edhe në rrugë të ndërlikuara. Përveç makinave, transporti publik do të përfitojë gjithashtu nga IA. Rrjetet e transportit do të menaxhohen më mirë falë analizës së të dhënave të mëdha, duke optimizuar oraret dhe ulur ndotjen.

Banka dhe siguria financiare: Optimizimi i proceseve dhe lufta ndaj mashtrimeve

Në sektorin bankar, IA do të përdoret për të përmirësuar procesin e dhënies së kredive dhe për të përforcuar sistemet kundër mashtrimeve. Bankat do të ofrojnë shërbime të personalizuara për klientët e tyre përmes asistentëve virtualë që do të ndihmojnë në menaxhimin e financave personale dhe zgjidhjen e problemeve komplekse. Ndërkohë, siguria kibernetike do të jetë një tjetër fushë ku IA do të luajë një rol të rëndësishëm. Me avancimin e sulmeve kibernetike, sistemet inteligjente do të jenë të afta

të analizojnë dhe parandalojnë kërcënimet në kohë reale, duke reduktuar rrezikun e vjedhjes së të dhënave dhe mashtrimeve financiare.

Argëtimi dhe mediat: Personalizimi i përvojës

Industria e argëtimit do të ndryshojë ndjeshëm. Në platforma si Netflix dhe Spotify, algoritmet e IA-së tashmë rekomandojnë përmbajtje bazuar në preferencat tona. Megjithatë, në të ardhmen, do të mund të shohim filma dhe të luajmë videolojëra ku rrëfimet dhe skenarët do të përshtaten sipas preferencave tona, duke krijuar një përvojë unike për çdo përdorues. Në fushën e muzikës dhe artit, IA po përdoret për të krijuar këngë dhe vepra arti origjinale. Brenda pak vitesh, mund të kemi asistencë krijuese që do të ndihmojë artistët të eksplorojnë forma të reja të shprehjes.

Marrëdhëniet sociale dhe etika: Sfida të reja

Ndikimi i IA-së nuk do të kufizohet vetëm në fusha praktike, por do të prekë edhe marrëdhëniet njerëzore. Rritja e asistentëve virtualë inteligjentë mund të çojë në një ndryshim të madh në mënyrën se si ndërveprojmë me njëri-tjetrin. Një studim i fundit tregon se një në katër të rinj nën 40 vjeç mendon se IA mund të zëvendësojë një marrëdhënie romantike tradicionale. Megjithatë, kjo sjell sfida të mëdha etike. Si mund të garantojmë që IA të mos manipulojë njerëzit emocionalisht? A do të jetë e mundur të vendosen kufizime për të mbrojtur privatësinë dhe vlerat njerëzore? Inteligjenca Artificiale do të sjellë transformime të mëdha në të gjitha aspektet e jetës. Megjithëse përfitimet e saj janë të mëdha, rreziqet dhe sfidat etike duhet të adresohen me kujdes. Një nga sfidat më të mëdha do të jetë balancimi midis inovacionit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Në pesë vitet e ardhshme, suksesi i shoqërisë sonë do të varet nga mënyra se si e përdorim këtë teknologji dhe si vendosim kufizimet e duhura. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Sot fillon stinori pranveror në Superligën e Hendbollit

PRISHTINË, 31 JANAR - Me dy ndeshje që zhvillohen të shtunën, fillon stinori pranveror në Superligën e Kosovës në hendboll në konkurrencë të meshkujve. Në program është xhironja e 15-të, ndërsa shpresohet në ndeshje

interesante e me rivalitet. Nga ora 19:30 në palestrën “Minatori” në Mitrovicë takohen Trepça e Vushtrria. Ndërkohë prej orës 20:00 në palestrën “Karagaçi” në Pejë është derbi i xhironës në mes të Besa Famgasit e Rahovecit. Të

dielën nga ora 16:00 është takimi Llapi - Prishtina, ndërsa ndeshja Vjosa - Kastrioti është shtyrë. Stinorin pranveror nga pozita e parë e nis Rahoveci. “Vreshtarët” i kanë fituar të gjitha 14 ndeshjet e vjeshtës dhe mbajnë vendin e parë me

28 pikë. Nga 22 pikë në pozitën dy e tre i kanë Besa Famgas e Kastrioti. Prishtina renditet e katërta me 16 pikë e Vushtrria e pesta me tetë pikë. Nga tetë pikë i kanë edhe Vjosa e Llapi në pozitën gjashtë e shtatë. Trepça është e fundit, ndërsa



pikët e para i kërkon në xhiron e parë të pranverës.

Besart Baruti zgjidhet kryetar i Federatës së Karatesë

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 31 JANAR - Federata e Karatesë e Kosovës ka mbajtur zgjedhjet e rregullta për Ciklin Olimpik 2025-2028, duke zgjedhur organet e reja drejtuese që do ta udhëheqin federatën gjatë katër viteve të ardhshme. Kuvendi u monitorua nga Shkëlqim Sadriu nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) dhe Milaim Kelmendi nga Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK). Pas një procesi demokratik dhe transparent, delegatët e pranishëm votuan

dhe zgjedhën me të gjitha votat për kryetarin e Federatës së Karatesë së Kosovës, Besart Barutin. Nënkryetarë të FKK-së janë zgjedhur Ismail Fazliu dhe Gazmend Havolli, ndërsa anëtarë të Bordit Ekzekutiv: Bashkim Ibrahim, Shkëlzen Berisha, Halil Mahalla, Shkëlzen Shala, Muhamet Kolgeci, Shkelzen Balaj, Eranda Krasniqi-Ramadani, Yll Gashi. Fortesa Orana është zgjedhur përfaqësuese e Sportistëve, kurse Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga Festim Krasniqi, Ferat Rukolli, Ideal Berisha. “Falënderojmë të gjithë

pjesëmarrësit për përkushtimin dhe besimin e treguar në këtë proces, ndërsa të zgjedhurve të rinj ju urojmë suksese dhe një mandat të mbarë në përmbushjen e objektivave për avancimin e karatesë kosovare”, thuhet në njoftimin e FKK-së. Bordi Ekzekutiv mbajti mbledhje konstituive pas Kuvendit Zgjedhor, me ç’rast kryetari emëroi tre anëtarët, Valon Qelaj, Gresa Zhitia, Gentiana Gashi-Pepaj, duke kompletuar Bordin prej 15 anëtarëve. Po me propozim të kryetarit të FKK-së iu vazhdua mandati edhe sekretarit të përgjithshëm, Nazmi Gashi.



Të dielën zhvillohen katër ndeshjet në elitën e basketbollit



PRIZREN, 31 JANAR - Pas emocioneve të Kupës, adrenalina në basketboll vazhdon me super-ndeshjet në ProCredit Superligën e Kosovës në basketboll, ku zhvillohet xhironja e 20. Të gjitha ndeshjet do të

PROCREDIT SUPERLIGA - JAVA 20

Të dielën takohen:
16:00 Proton Cable Prizreni - Bora
16:00 Vëllaznimi - Golden Eagle Ylli
19:00 Trepça - Peja
19:00 Bashkimi - Sigal Prishtina

zhvillohen të dielën, ku secila përballje është shumë e rëndësishme. Proton Cable Prizreni-Bora është një takim shumë i rëndësishëm pasi përballen vendet shtatë dhe tetë. Prizrenasit kanë katër fitore e 15 humbje, ndërsa prishtinasit kanë gjashtë fitore e 13 humbje. Ndeshje mjaft interesante shihet edhe ajo ndërmjet Vëllaznimit dhe Golden Eagle Yllit. Kuqezinjtë kanë dhjetë fitore e nëntë humbje, derisa therandasit tetë fitore e 11 humbje. Bashkimi - Sigal Prishtina

është një përballje mjaft interesante, ku pritet atmosferë e jashtëzakonshme në “Sezai Surroi”. Prizrenasit janë në vendin e parë me 14 fitore e pesë humbje, derisa bardhekaltrit në pozitën e tretë me 11 fitore e tetë humbje. Derbi është edhe dueli ndërmjet Trepçës dhe Pejës ku, po ashtu, pritet një atmosferë e ‘zjarrtë’ në “Minatori”. “Xehetarët” janë në vendin e dytë me 13 fitore e gjashtë humbje, kurse pejanët në pozitën e katërt me dhjetë fitore e nëntë humbje.

Futbolli rikthehet më 7 shkurt



PRISHTINË, 31 JANAR - Komisioni Ekzekutiv i Federatës së Futbollit të Kosovës e ka mbajtur mbledhjen e radhës udhëhequr nga presidenti Agim Ademi, në të cilën janë diskutuar një sërë çështjesh të

rëndësishme. Ndër pikat kryesore të mbledhjes ishte edhe fillimi i stinorit pranveror ku, sipas planprogramit, Albi Mall Superliga do të nisë më 7 shkurt, ndërsa Liga e Parë më 15 shkurt. “Me këtë rast u

konstatua se FFK, me të gjitha organet e saj, tashmë i ka bërë të gjitha përgatitjet e duhura për vazhdimin e garave, ndërsa ekipet janë në përfundim të fazës përgatitore. KE i FFK-së me këtë rast u

uron suksese të gjitha klubeve dhe kërkon që të mbizotërojë fryma e ‘fair-play’-it, teksa garanton garë të drejtë dhe rregullsi maksimale”, thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit të Kosovës.

Xhudistët e Kosovës, gati për ‘Grand Slam Paris’

PRISHTINË, 31 JANAR - Distria Krasniqi, Nora Gjakova, Erza Muminoviq, Akil Gjakova dhe Dardan Cena janë pesë xhudistët e Kosovës që do të marrin pjesë në Grand Slamin e Parisit.

Të drejtuar nga mjeshtri Driton Kuka dhe ndihmësi i tij Fatos Tabaku, xhudistët tanë presin medalje në Paris, për ta mbushur edhe më shumë raftin e medaljeve prestigjioze për Kosovën.

Ky event prestigjioz do të mbledhë 308 garues nga 53 shtete e 4 kontinente, duke garantuar spektakël të jashtëzakonshëm të xhudos në Francë. Ky grand slam zhvillohet gjatë ditës së shtunë, e

ekipi ynë do të luftojë për medalje në njërin nga garat më të mëdha të vitit. Nga sporti i xhudos, Kosova ka pesë medalje olimpike, tri të arta, një të argjendtë dhe një të bronzë.



Shorti i Ligës së Kampionëve, City përballët me Realin

NYON, 31 JANAR - Në Nyon të Zvicrës është hedhur shorti për fazën e 'play-off'-it të Ligës së Kampionëve. Nuk mungojnë përballjet e forta dhe interesante. Dueli më i fortë është padyshim ai mes Manchester Cityt dhe Real Madridit, të cilët do të

takohen për herë të katërt radhazi dhe pritet që në të dyja përballjet të ketë një spektakël të vërtetë. Me fat mund të konsiderohet PSG-ja e cila do të luajë përballë Brestit teksa Bayern Munichu, që iu shmang Manchester Cityt, do ta ketë

përballë Celticun. Kujtojmë se faza e 'play-off'-it në Ligën e Kampionëve pritet të fillojë me ndeshjet e para me datat 11-12 shkurt, teksa ato të kthimit një javë më vonë. Fituesit e ndeshjeve të 'play-off'-it do të kualifikohen tutje në

raundin e 1/16, aty ku tetë ekipet e para të fazës së ligës do të presin për t'u ballafaquar me to. Në përballjet e tjera takohen: Club Brugge-Atalanta, Sporting-Borussia Dortmund, Manchester City-Real Madrid, Celtic-



Bayern Munich, Juventus-PSV, Feyenoord-Milan, Brest-PSG, Monaco-Benfica.

Muriqi për mungesën e golave: Kam përvojë për t'i rikthyer gjërat përmbys

MALLORCA, 31 JANAR - Vedat Muriqi e ka pranuar se po kalon nëpër një çast të vështirë të karrierës. Sulmuesi nga Kosova ka dhënë një intervistë për mediumin spanjoll "Onda Cero", në të cilën foli për situatën aktuale. 30-vjeçari i ka shënuar vetëm tre gola në këtë sezon, ndërsa i ka dhuruar edhe dy asistime nga 18 ndeshje të zhvilluara në të gjitha garat, statistika këto të zbehta, duke pasur parasysh se në sezonet e kaluara ishte protagonist tek ekipi ishullor, të cilin e ndihmoi tri herë që të mbetej në La Liga. "Sulmuesi gjendet në telashe nëse nuk shënon gola. Sezonin e kaluar unë u përballa me një lëndim serioz, por ia dola ta



menaxhoja situatën dhe i shënova shtatë gola. Këtë vit, përkundër faktit se ekipi ynë ka më shumë posedim dhe po krijon më shumë raste, numri i golave të mia është zvogëluar", ka deklaruar fillimisht ish-futbollisti i Rizesporit, Fenerbahçes e Lazios. "E gjëj

veten në një pikë të vështirë, por unë kam përvojë të mjaftueshme për t'i rikthyer gjërat përmbys, pasi ekipi ka nevojë për më shumë fitore dhe unë për gola. Jam i vendosur që ta thyej këtë rënie personale", ka shtuar Muriqi. "Roli im primar është që t'i ndihmoj shokët e skuadrës. Shënimi i golave është kolektiv. Sidoqoftë, nëse unë nuk e gjej golin, trajneri duhet të bëjë zgjidhje alternative. Ky është një veprim i arsyeshëm dhe unë duhet të kontribuoj sa të mundem", ka përfunduar prizrenas. Ky mund të jetë sezoni i fundit i Muriqit në Mallorca pasi spekulohet se gjatë vërës që vjen ai mund të rikthehet në futbollin turk.

Asnjë surprizë, Clevelandi dhe lakersat bëjnë detyrën



WASHINGTON, 31 JANAR - Nuk pati surpriza në mbrëmjen e së enjtes në NBA, me skuadrat pretendente që arritën t'i fitonin lehtësisht sfidat e tyre të radhës. Kështu Clevelandi vijon ta komandojë renditjen e NBA-s pas fitores 137-115 ndaj Atlantës. Shtatë lojtarë të

ekipit vendës realizuan mbi 10 pikë, ku dyshja Garland-Mitchell së bashku realizoi 50 pikë. Ndeshje mjaft e mirë edhe nga Mobley që realizoi një double double, teksa realizoi 16 pikë dhe 10 rebounde. Pa problem fitoi jashtë fushës ekipi i lakersave, që

mundi me rezultat 134-96 Washingtonin. Të gjithë titullarët e lakersave realizuan mbi 10 pikë, ku spikati LeBron Jamesi me 24 pikë e 11 asistime. Ndeshje shumë e mirë edhe për James Jr, të birin e "yllit" të Los Angeles Lakersit, që arriti të realizojë 5 pikë, 2 asistime si dhe kapi 2 topa në tabelë. Fitore në sekondën e fundit për Memphisin, që mundi me rezultat 120-119 Houstonin, ndeshje ku u dallua Desmond Bane me 24 pikë e 12 rebounde. Skuadra e Portlandit, falë Scoot Hendersonit (23 pikë), mundi me rezultat 119-90 Orlandon.

REZULTATET

Cleveland - Atlanta	137-115
Washington - Lakers	96-134
Utah Jazz - Minnesota	113-138
Memphis - Houston	120-119
Portland - Orlando	119-90

Guardiola: Për momentin Arsenali është përpara nesh

Të dielën në Londër do të zhvillohet sfida e madhe në Premierë Ligë mes Arsenalit dhe Manchester Cityt. Nëse "Topçinjtë" janë ende pretendentë në kampionat, një gjë e tillë nuk duket se po ndodh me kampionët në fuqi të "Citizens"-it.

Trajneri Pep Guardiola, duke folur në konferencën për shtyp përpara ndeshjes së Manchester Cityt me Arsenalin, tha: "Ne jemi një ekip i vjetër. Ne nuk kemi shumë lojtarë në dispozicion dhe ata që zbresin në fushë luajnë shumë minuta. Ky është një realitet. Prandaj

është e frikshme të luash ndeshje kalimtare kundër Liverpoolit, Arsenalit, Newcastle, Aston Villas dhe Brightonit. Ata janë kilometra më të mirë se ne. E pranoj se ne ende kemi cilësinë, por çdo sezon është ndryshe nga ai i kaluar dhe problemet që kemi

janë të ndryshme", ka thënë Guardiola. "Kohët e fundit ne po marrim rezultate, përveç ndeshjes me PSG-në, pra ne jemi ende atje. Jo për ta fituar titullin kundër Liverpoolit apo Arsenalit. Në asnjë mënyrë nuk mund ta mendojmë këtë gjë, por ne jemi atje. Ndonjëherë ju

keni perspektivën se është e pamundur sot, por nesër, mendësia dhe atmosfera sjellin ndryshim. Jam shumë i sigurt se do të provojmë të luajmë e fitojmë ndaj Arsenalit, por ai është shumë përpara nesh në të gjitha drejtimet", ka shtuar Guardiola.

SHKURT

Usyk: Fury nuk ka qenë boksieri më i rrezikshëm që jam përballur

Boksieri ukrainas Oleksandr Usyk, i cili mban titujt kampionë bote në peshën e rëndë në kategoritë WBA, WBO e WBC, ka folur për kundërshtarin e tij më të rrezikshëm në karrierë. Ai befasoi duke thënë se rivali më i rrezikshëm ishte Derek Chisora. Usyk shprehu respektin e tij për Furyn, por vuri në dukje se Chisora ishte jashtëzakonisht i fortë dhe i futi frikën. "Unë e respektoj Furyn. Ai është një njeri i madh dhe besoj se kjo ishte lufta ime më e vështirë, por më e rrezikshmja ishte sfida ndaj Chisora", ka thënë Usyk. "Derek ishte një djalë shumë i ashpër. Derek bokson si me dorën e djathtë ashtu dhe atë të majtë dhe, kur u përpoqa ta bllokoja, mendova: 'O Zot, largohu, kjo është e rrezikshme'", u shpreh Oleksandr Usyk. Usyk nuk ka konfirmuar ende se kur do të rikthehet pasi fitoi me vendim unanim edhe revanshin ndaj Tyson Furyt. Ai deklaroi se ka në plan ta vazhdojë karrierën, por nuk dihet as data e as rivali i radhës.

Al Nassri ofron 85 milionë euro për Leao

Stefano Pioli kërkon ta marrë tek Al Nassri një njohje të tij të vjetër, portugezin Rafael Leao, të cilin e ka trajnuar për katër sezone e gjysmë te kuqezinjtë e Milanit. Klubi saudit është i gatshëm të investojë një shifër midis 70 dhe 85 milionë euro për Leao, por operacioni u bllokua në fillim nga Milani që nuk dëshiron të shesë një lojtar kaq të rëndësishëm, aq më tepër pak orë para fundit të merkatos dimërore. Leao mbetet një lojtar shumë i vlerësuar. Nuk është hera e parë që ai lidhet me Ligën Pro Saudite dhe nuk duhet ta harrojmë tentativën e Barcelonës verën e kaluar. Lojtari kohët e fundit ishte betuar për besnikëri ndaj Milanit.

Hermoso nënshkruan me Leverkusenin

Bayer 04 Leverkuseni ka nënshkruar me qendërmbrojtësin spanjoll Mario Hermoso. 29-vjeçari do të kalojë nga klubi i divizionit të parë italian AS Roma te kampionët gjermanë dhe fituesit e Kupës së Gjermanisë në formë huazimi me efekt të menjëhershëm deri më 30 qershor 2025. Edhe Roma zyrtarizon largimin e përkohshëm të mbrojtësit. Me mbërritjen në kryeqytetin italian në vitin 2024, mbrojtësi spanjoll ka bërë 13 paraqitje dhe 1 gol për verdhekuqtë. Klubi i uron Marios fat më të mirë për aventurën e tij të re në Bundesligë.

**KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE “PASTRIMI” SH.A**

Duke u bazuar në Ligjin Nr. Ligjin Nr. 03/L-212 i Punës konkretisht Neni 8 Udhëzimin Administrativ MFPT Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik konkretisht Neni 5 Paragrafi 1,2 dhe Neni 7, Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM “Pastrimi” SH.A, Vendimin e datës 29.01.2025 me numër të protokollit 08/07/4 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM “Pastrimi” SH.A, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK

(Për plotësimin e vendit të punës)

Titulli i vendit të Punës: "Punëtor i Bartjes" në KRM "Pastrimi" SH.A (10) pozita;

Departamenti: Drejtoria e Operativës;

Numri i Referencës: DO/KJ-03/2025:

Koeficienti/Paga mujore: Niveli XIII;

Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: Me kohë të pa caktuar.

Periudha Provuese: 3 muaj

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bënë mbledhjen e mbeturinave në zonat e caktuara;
- Bënë zbrazen e kontejnerëve në automjet/kamion;
- Bënë pastrimin e zonës përreth kontejnerëve;
- Bazuar në planin operativ dhe urdhëresës së punës bënë pastrimin dhe larjen e rrugëve dhe trotuareve;
- Bënë pastrimin e trotuareve dhe rrugëve nga bora dhe hudhien e kripës;
- Bënë largimin e kafshëve të ngordhura nga rruga dhe vendosjen e tyre në kontejnerin përkatës;
- Është përgjegjës për mirësjellje ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve të kompanisë;
- Është përgjegjës që pas mbledhjes së mbeturinave, kontejnerët ti vendosë në vendin paraprak;
- Kujdeset dhe është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të mjeteve të punës dhe kontejnerëve;
- Kryen edhe punë të tjera me të cilat e angazhon udhëheqësi;
- Për punën e tij i raporton Udhëheqësit të Njesisë së Bartjes në Prishtinë

2. Kriteret e përgjithshme për pranim në detyrë:

- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- ✓ Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- ✓ Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- ✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- ✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- ✓ Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën;
- ✓ Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- ✓ **Arsimimi i kërkuar:** Shkollim i mesëm apo shkollimi fillor
- ✓ **Përvoja e punës e kërkuar:** 2 vite përvojë pune në fushën përkatëse.

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- ✓ Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- ✓ Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar;
- ✓ Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- ✓ Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- ✓ Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- ✓ Aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati:

- ✓ Kopje të diplomave të dhëna nga Institucionet Arsimore;
- ✓ Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës);
- ✓ Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve;
- ✓ Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit, (e dëshirushme);
- ✓ Kopje të letërnjohjimit;
- ✓ Vërtetimin që nuk është i dënuar për kryerjen e një veprës penale jo më të vjetër se 3 muaj.

6. Mënyra e aplikimit në konkurs:

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në Zyret e Burimeve Njerëzore në KRM "Pastrimi" SH.A.

Të gjitha aplikimet duhet të bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet platformës elektronike:
punesimi.krmpastrimi@gmail.com

7. Data dhe ora e saktë e përmbylljes së Konkursit Publik:

Konkursi publik zgjatë 15 ditë nga data: 31.01.2025 deri me datën 17.02.2025 Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00.

Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

8. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit:

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të CV-së, testit me shkrim dhe me intervistim (test verbal).

- ✓ CV-ja e kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë;
- ✓ Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë;
- ✓ Intervista (testi me gojë) vlerësohet deri në njëzetë (20) pikë.

Procedura e vlerësimit përmban gjithësejt njëqind (100) pikë, ku kalushmëria është arritura e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët:

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimin elektronik dhe individualisht.

10. Kalendari i përafërt i procedures së rekrutimit:

Konkursi është i hapur deri me datën 17.02.2025.

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri 7 ditë;

Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit;

Faza e Intervistes deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim;

Publikimi i rezultateve deri 5 ditë pas vlerësimit të intervistë.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ilir Zymeraj nga Petkoviq KK Rahovec shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Rilindja" në Qifllak KK Rahovec
 - Vesa Xhepa nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11,12 si dhe diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.
 - Atdhe Mustafa nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme "Kadri Kusari"
 - Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
 - Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
 - Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
 - Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
